

VENDIM
Nr.12, datë 6.1.2011

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
QAFËTHANË – LIN - POGRADEC, LOTI I**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qafëthanë-Lin-Pogradec, loti I.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 5191 (pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e një) m², tokë arë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 1 371 981.3 (një milion e treqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një pikë tre) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 602 500 (gjashtëqind e dy mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 1 371 981. 3 (një milion e treqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një pikë tre) lekë, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 15.1.2011 dhe të përfundojë më 15.4.2011.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë të rifreskuar brenda afateve ligjore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve sipas pikave 6 e 7 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Pogradec, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, si dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Pogradec, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Pogradec, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha